



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/337

Datë: 12.09.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/15 qershor 2008, nenit 19 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e dytë të mbledhjes së -IX- të mbajtur me datë: 07.09.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E HAPSIRAVE PËR ZYREN E KRYESUESIT TË KUVENDIT DHE TË
GRUPEVE POLITIKE NË KUVENDIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS

1. Miratohet vendimi për renovimin e objektit të Komunës me mjete nga buxheti i Komunës për vitin 2019, dhe do të behët ndarja e zyreve për kryesuesin afër sallës së Kuvendit të Komunës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi të behët zgjidhja e përkohshme për zyren e kryesuesit deri në renovimin e objektit të Komunës, po ashtu kryesuesi me asistenten e tij mbeten në zyrën aktuale, ndërsa dy zyrtaret e Kuvendit kalojnë në katin e tretë në zyrën e zyrtarit z.Shefqet Kryeziu i cili pastaj sistemohet në zyret e DKAË-së nga drejtori i Drejtorisë.
3. Zyret për grupet e anëtarëve të Kuvendit nga NISMA-SOCIALDEMOKRATE, PDK, LDK dhe VV ndahen në objektin e Muzeut të Qytetit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari përmes Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme duke lëshuar këto zyre menjëherë për grupet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
Drejtorive të KK-së
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina